

URDHËR
Nr. 249, datë 30.12.2025

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË URDHRIN NR. 170, DATË 13.9.2022,
PËR MIRATIMIN E RREGULLORES “PËR PËRCAKTIMIN E KËRKESAVE DHE
PROCEDURAVE ADMINISTRATIVE QË LIDHEN ME AERODROMET NË
REPUBLIKËN E SHQIPËRISË¹”, I NDRYSHUAR**

Në zbatim të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës; të shkronjës “ç”, të nenit 7 dhe pikës 10, të nenit 54, të ligjit nr. 96/2020, “Kodi Ajror i Republikës së Shqipërisë”; të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1095, datë 24.12.2020, “Për miratimin e kërkesave thelbësore në fushën e aviacionit civil”, të ndryshuar dhe në përputhje me ligjin nr. 9658, datë 18.12.2006, “Për ratifikimin e marrëveshjes shumëpalëshe ndërmjet Komunitetit Evropian dhe shteteve anëtare të tij, Republikës së Shqipërisë, Bosnjës dhe Hercegovinës, Republikës së Bullgarisë, Republikës së Kroacisë, Republikës së Maqedonisë, Republikës së Islandës, Republikës së Malit të Zi, Mbretërisë së Norvegjisë, Republikës së Rumanisë, Republikës së Serbisë dhe Misionit Administrativ të Përkohshëm të Kombeve të Bashkuara në Kosovë për krijimin e një zone të përbashkët të aviacionit evropian”,

URDHËROJ:

1. Në rregulloren e miratuar me urdhrin nr. 170, datë 13.9.2022, “Për miratimin e rregullores për përcaktimin e kërkesave dhe procedurave administrative që lidhen me aerodromet në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, bëhen shtesat dhe ndryshimet sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij urdhri dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohet Autoriteti i Aviacionit Civil për ndjekjen dhe zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSKRYEMINISTËR
DHE MINISTËR I INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË
Belinda Balluku**

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË RREGULLOREN “PËR PËRCAKTIMIN
E KËRKESAVE DHE PROCEDURAVE ADMINISTRATIVE QË LIDHEN ME
AERODROMET NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”**

I. DISPOZITAT NDRYSHUESE

1. Nenet 4 dhe 5 shfuqizohen.

2. Në nenin 7, pas paragrafit 3, shtohet paragrafi 4, si më poshtë:

“4. “Dokumenti i Pranimit të Devijimit dhe Veprimit” (DPDV) i bashkangjitur certifikatës do t’i transferohet operatorit të ri të aerodromit të cilit do t’i transferohet menaxhimi i aerodromit, me kusht që të plotësohen kushtet e përmendura në paragrafët 1 dhe 3.”.

3. Në aneksin I bëhen ndryshimet si më poshtë:

a) pas pikës 4 shtohet pika 4/”a”, si më poshtë:

¹ Ky urdhër përaftron plotësisht rregulloret e BE-së nr. 2022/2074, botuar në Fletoren Zyrtare të BE-së L 280, datë 18.10.2022, nr. 2024/894, botuar në Fletoren Zyrtare të BE-së L 894, datë 20.3.2024, nr. 2024/405, botuar në Fletoren Zyrtare të BE-së L 2024/405, datë 11.4.2024, nr. 2024/1400, botuar në Fletoren Zyrtare të BE-së L 2024/1400, datë 24.5.2024, nr. 2025/21, botuar në Fletoren Zyrtare të BE-së L 2025/21, datë 7.3.2025 dhe pjesërisht Rregulloret nr. 2022/1645, botuar në Fletoren Zyrtare të BE-së L 248, datë 26.9.2022, nr. 2023/203, botuar në Fletoren Zyrtare të BE-së L 31, datë 2.2.2023.

“4a. “Dendësia e trafikut të aerodromit” nënkupton numrin e lëvizjeve në orën mesatare më të ngarkuar dhe është mesatarja aritmetike gjatë vitit, të numrit të lëvizjeve në orën më të ngarkuar ditore;”;

b) pas pikës 19/”a” shtohet pika 19/”b”, si më poshtë:

“19b “Pikë e nxehtë” nënkupton një vendndodhje në një zonë të lëvizjes së aerodromit me një historik ose rrezik të mundshëm përplasjeje ose inkursioni në pistë dhe ku është e nevojshme një vëmendje e shtuar nga pilotët ose drejtuesit e mjeteve;”;

c) pika 65 zëvendësohet me sa vijon:

“65. “SNOWTAM” do të thotë një seri e posaçme NOTAM gjeneruar në një format standard, i cili siguron një raport të kushteve të sipërfaqes që njofton praninë ose ndërprerjen e kushteve të rrezikshme për shkak të borës, akullit, llucës, ngricës, ujit të ndenjur ose ujit të lidhur me dëborën, baltën, akullin ose ngricat në zonën e lëvizjes.”;

ç) pika 72 zëvendësohet me sa vijon:

“72. “Kushtet e certifikatës” nënkupton të gjitha sa vijon:

- Treguesit e vendndodhjes sipas ICAO-s;
- kushtet e operimit (VFR/IFR, ditë/natë);
- operimet e avionit në pistat dimërore të përgatitura posaçërisht;
- pistën – distancat e deklaruara;
- llojet e pistës dhe afrimet e ofruara;
- kodin e referencës së aerodromit;
- fushëveprimin e operateve të avionëve që tejkalojnë karakteristikat e certifikuara të projektimit të aerodromit;

- ofrimin e shërbimeve të menaxhimit të vendqëndrimit të avionëve (po/jo);

- nivelin e mbrojtjes për shërbimet e shpëtimit dhe fikjes së zjarrit.”.

4. Në aneksin II (Pjesa – ADR.AR) bëhen ndryshimet, si më poshtë:

1. në pikën ADR.AR.A.025, shkronjat “a” dhe “b” zëvendësohen, si më poshtë:

“a) Kur është e zbatueshme sipas përcaktimeve të marrëveshjes shumëpalëshe, Autoriteti i Aviacionit Civil do të njoftojë pa vonesë Agjencinë në rast të ndonjë problemi të rëndësishëm me zbatimin e VKM-së nr. 1095, datë 24.12.2020, “Për miratimin e kërkesave thelbësore në fushën e aviacionit civil”, i ndryshuar, dhe akteve nënligjore në zbatim të tij, dhe në çdo rast, brenda 30 ditëve nga momenti kur ka marrë dijeni për këto probleme të rëndësishme;

b) Kur është e zbatueshme sipas përcaktimeve të marrëveshjes shumëpalëshe, pa cenuar urdhrin e ministrit nr. 89, datë 5.5.2022, “Për miratimin e rregullores për raportimin dhe ndjekjen e ngjarjeve në aviacionin civil në Republikën e Shqipërisë”, Autoriteti i Aviacionit Civil do të vërë në dispozicion të Agjencisë informacionet e rëndësishme që lidhen me sigurinë në operim, të cilat rrjedhin nga raportet e ngjarjeve të ruajtura në bazën e të dhënave kombëtare, në përputhje me nenin 6/6 të urdhrin të ministrit nr. 89, datë 5.5.2022, “Për miratimin e rregullores për raportimin dhe ndjekjen e ngjarjeve në aviacionin civil në Republikën e Shqipërisë”, sa më shpejt që të jetë e mundur.”.

2. Në pikën ADR.AR.A.025 pas shkronjës “b” shtohet shkronja “c”, si më poshtë:

“c) Kur të jetë e zbatueshme sipas përcaktimeve të marrëveshjes shumëpalëshe, Autoriteti i Aviacionit Civil do të vërë në dispozicion të Agjencisë informacionet e rëndësishme që lidhen me sigurinë në operim, të cilat rrjedhin nga raportet e sigurisë së informacionit që ka marrë në përputhje me pikën IS.D.OR.230, të aneksit (Pjesa – IS.D.OR) të rregullores së deleguar të BE-së 2022/1645, në lidhje me kërkesat për menaxhimin e rreziqeve të sigurisë së informacionit me një ndikim të mundshëm në sigurinë në operim për organizatat kur të jetë e zbatueshme me përafrimin e saj me legjislacionin e brendshëm.”.

3. Në pikën ADR.AR.A.030, shkronjat “a”, “b” dhe “c” zëvendësohen, si më poshtë:

“a) Pa cenuar urdhrin e ministrit nr. 89, datë 5.5.2022, “Për miratimin e rregullores për raportimin dhe ndjekjen e ngjarjeve në aviacionin civil në Republikën e Shqipërisë”, Autoriteti

i Aviacionit Civil do të zbatojë një sistem për mbledhjen, analizimin dhe shpërndarjen e duhur të informacionit të sigurisë në operim;

b) Agjencia zbaton një sistem për të analizuar në mënyrë të përshtatshme çdo informacion të marrë që lidhet me sigurinë në operim dhe pa vonesa të panevojshme i siguron autoritetit përkatës të shteteve anëtare të ZPEA-së dhe Komisionit çdo informacion, duke përfshirë rekomandimet ose veprimet korrigjuese që duhet të ndërmerren, të nevojshme për ata që të reagojnë në kohën e duhur për një problem të sigurisë në operim që përfshin aerodromet, operatorët e aerodromit dhe organizatat përgjegjëse për ofrimin e AMS-së, të cilët i nënshtrohen VKM-së nr. 1095, datë 24.12.2020, “Për miratimin e kërkesave thelbësore në fushën e aviacionit civil”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore në zbatim të tij;

c) Me marrjen e informacionit të përmendur në shkronjën “a” dhe kur është e zbatueshme në shkronjën “b”, Autoriteti i Aviacionit Civil do të marrë masat e duhura për të adresuar problemin e sigurisë në operim, duke përfshirë nxjerrjen e direktivave të sigurisë në operim në përputhje me pikën ADR.AR.A.040.”.

4. Pas pikës ADR.AR.A.030 shtohet pika ADR.AR.A.030A, si më poshtë:

ADR.AR.A.030A Reagimi i menjëhershëm ndaj një incidenti ose cenueshmërie të sigurisë së informacionit me ndikim në sigurinë në operim të aviacionit

a) Autoriteti i Aviacionit Civil do të zbatojë një sistem për mbledhjen, analizimin dhe shpërndarjen e duhur të informacionit, në lidhje me incidentet dhe cenueshmëritë e sigurisë së informacionit me një ndikim të mundshëm në sigurinë në operim që raportohen nga organizatat. Kjo do të bëhet në koordinim me çdo autoritet tjetër përkatës përgjegjës për sigurinë e informacionit ose sigurinë kibernetike brenda Republikës së Shqipërisë për të rritur koordinimin dhe përputhshmërinë e skemave të raportimit;

b) Agjencia zbaton një sistem për të analizuar në mënyrë të përshtatshme çdo informacion të rëndësishëm për sigurinë në operim të marrë në përputhje me pikën ADR.AR.A.025“c” dhe pa vonesë të panevojshme i ofron shteteve anëtare dhe Komisionit çdo informacion, duke përfshirë rekomandimet ose veprimet korrigjuese që duhen ndërmarrë, të nevojshme që ato të reagojnë në kohën e duhur ndaj një incidenti ose cenueshmërie të sigurisë së informacionit me një ndikim të mundshëm në sigurinë e aviacionit që përfshin produkte, pjesë, pajisje të pinstaluara, persona ose organizata që i nënshtrohen VKM-së nr. 1095, datë 24.12.2020, “Për miratimin e kërkesave thelbësore në fushën e aviacionit civil”, i ndryshuar, dhe akteve nënligjore në zbatim të tij;

c) Pas marrjes së informacionit të përmendur në shkronjën “a” dhe, kur është e zbatueshme, në shkronjën “b”, Autoriteti i Aviacionit Civil duhet të marrë masa të mjaftueshme për të adresuar ndikimin e mundshëm në sigurinë e aviacionit të incidentit ose cenueshmërisë së sigurisë së informacionit;

d) Masat e marra në përputhje me shkronjën “c” duhet t’u njoftohen menjëherë të gjithë personave ose organizatave që duhet t’i zbatojnë ato sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1095, datë 24.12.2020, “Për miratimin e kërkesave thelbësore në fushën e aviacionit civil”, i ndryshuar, dhe akteve nënligjore në zbatim të tij. Autoriteti i Aviacionit Civil duhet gjithashtu t’i a njoftojë këto masa Agjencisë dhe kur kërkohet veprim i kombinuar, autoriteteve kompetente të shteteve të tjera anëtare të përfshira.”.

5. Pika ADR.AR.B.005 ndryshohet, si më poshtë:

a) shkronja “a”/1 zëvendësohet me sa vijon:

“1. Politikat dhe procedurat e dokumentuara për të përshkruar organizimin, mjetet dhe metodat e tij për të arritur pajtueshmërinë me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 1095, datë 24.12.2020, “Për miratimin e kërkesave thelbësore në fushën e aviacionit civil”, i ndryshuar, dhe akteve nënligjore në zbatim të tij. Procedurat do të mbahen të përditësuara dhe do të shërbejnë si dokumente themelore të punës brenda Autoritetit të Aviacionit Civil për të gjitha detyrat përkatëse”;

b) shkronja “c” zëvendësohet me sa vijon:

“c) Autoriteti i Aviacionit Civil do të vendosë procedurat për pjesëmarrjen në një shkëmbim të ndërsjellë të të gjithë informacionit dhe ndihmës së nevojshme me autoritetet e tjera kompetente të interesuara, qofshin brenda Shqipërisë ose nga shtete të tjera, duke përfshirë:

1. gjetjet përkatëse të ngritura dhe veprimet vijuese të ndërmarra si rezultat i mbikëqyrjes së organizatave përgjegjëse për ofrimin e AMS-së në territorin e Republikës së Shqipërisë, por që kanë deklaruar aktivitetet e tyre me më shumë se një autoritet kompetent ose në më shumë se një shtet;

2. informacionin që rrjedh nga raportimi i detyrueshëm dhe vullnetar i ngjarjeve siç kërkohet nga pikat ADR.OR.C.030 dhe ADR.OR.F.055.

d) Përveç kërkesave të përfshira në shkronjën “a”, sistemi i menaxhimit i krijuar dhe i mirëmbajtur nga Autoriteti i Aviacionit Civil duhet të jetë në përputhje me aneksin I (Pjesa – IS.AR) të rregullores zbatuese të BE 2023/203, në lidhje me kërkesat për menaxhimin e rreziqeve të sigurisë së informacionit me një ndikim të mundshëm në sigurinë në operim për organizatat dhe Autoritet Kompetente, kur të jetë e zbatueshme, me përafrimin e saj me legjislacionin e brendshëm, me qëllim që të sigurohet menaxhimi i duhur i rreziqeve të sigurisë së informacionit që mund të kenë ndikim në sigurinë në operim të aviacionit.”.

6. Pika ADR.AR.B.010 ndryshohet, si më poshtë:

i. titulli zëvendësohet me sa vijon:

“**ADR.AR.B.010. Ndarja e detyrave**”;

ii. shtohet shkronja “c”, si më poshtë:

“c) Lidhur me certifikimin dhe mbikëqyrjen e përputhshmërisë së organizatës me pikën ADR.OR.D.005A, Autoriteti i Aviacionit Civil mund t’u caktojë detyra subjekteve të kualifikuara në përputhje me shkronjën “a” ose çdo autoriteti përkatës përgjegjës për sigurinë e informacionit, ose sigurinë kibernetike brenda Republikës së Shqipërisë. Gjatë ndarjes së detyrave, Autoriteti i Aviacionit Civil duhet të sigurojë që:

1. të gjitha aspektet që lidhen me sigurinë në operim koordinohen dhe merren parasysh nga subjekti i kualifikuar ose autoriteti përkatës;

2. rezultatet e aktiviteteve të certifikimit dhe mbikëqyrjes të kryera nga subjekti i kualifikuar ose autoriteti përkatës janë të integruara në dosjet e përgjithshme të certifikimit dhe mbikëqyrjes së organizatës;

3. sistemi i vet i menaxhimit të sigurisë së informacionit, i krijuar në përputhje me pikën ADR.AR.B.005”e” mbulon të gjitha detyrat e certifikimit dhe mbikëqyrjes së vazhdueshme të kryera në emër të tij.”.

7. Pika ADR.AR.B.015 zëvendësohet, si më poshtë:

“ ADR.AR.B.015 Ndryshimet në sistemin e menaxhimit:

a) Autoriteti i Aviacionit Civil do të ketë një sistem për të identifikuar ndryshimet që ndikojnë në aftësinë për të kryer detyrat e tij dhe për të përmbushur përgjegjësitë e veta, siç përcaktohet në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 1095, datë 24.12.2020, “Për miratimin e kërkesave thelbësore në fushën e aviacionit civil”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore në zbatim të tij. Ky sistem do të mundësojë që ai të marrë masa, sipas nevojës për të siguruar që sistemi i menaxhimit të mbetet i përshtatshëm dhe efektiv;

b) Autoriteti i Aviacionit Civil do të përditësojë sistemin e tij të menaxhimit për të pasqyruar çdo ndryshim të mundshëm në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 1095, datë 24.12.2020, “Për miratimin e kërkesave thelbësore në fushën e aviacionit civil”, i ndryshuar, dhe në bazë të tij, në kohën e duhur për të siguruar zbatimin efektiv të sistemeve të tij të menaxhimit;

c) Kur të jetë e zbatueshme, Autoriteti i Aviacionit Civil do të njoftojë Agjencinë për ndryshimet që ndikojnë në aftësinë e tij për të kryer detyrat dhe përmbushur përgjegjësitë e veta të përcaktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 1095, datë 24.12.2020, “Për miratimin e kërkesave thelbësore në fushën e aviacionit civil”, i ndryshuar.”.

8. Në pikën ADR.AR.C.005, pas shkronjës “e” shtohet shkronja “f”, si më poshtë:

“f) Lidhur me certifikimin dhe mbikëqyrjen e përputhshmërisë së organizatës me pikën ADR.OR.D.005A, përveç përputhshmërisë me shkronjat “a” deri në “e”, Autoriteti i Aviacionit Civil duhet të shqyrtojë çdo miratim të dhënë sipas pikës IS.I.OR.200“e” të rregullores zbatuese (BE) 2023/203, në lidhje me kërkesat për menaxhimin e rreziqeve të sigurisë së informacionit me një ndikim të mundshëm në sigurinë në operim për organizatat dhe për autoritetet kompetente, kur të jetë e zbatueshme me përafrimin e saj me legjislacionin e brendshëm ose shkronjës IS.D.OR.200“e” të rregullores së deleguar të BE-së 2022/1645, në lidhje me kërkesat për menaxhimin e rreziqeve të sigurisë së informacionit me një ndikim të mundshëm në sigurinë në operim për organizatat, kur të jetë e zbatueshme me përafrimin e saj me legjislacionin e brendshëm, pas ciklit të zbatueshëm të auditimit të mbikëqyrjes dhe sa herë që zbatohen ndryshime në fushëveprimin e punës së organizatës.”.

9. në pikën ADR.AR.C.035, shkronja “c” zëvendësohet, me sa vijon:

“c) Autoriteti i Aviacionit Civil do të lëshojë certifikatën(at) e përmendura në shkronjën “b” kur operatori i aerodromit të ketë vërtetuar në mënyrë të pranueshme për Autoritetin e Aviacionit Civil përputhjen me kërkesat e pikave ADR.OR.B.025 dhe ADR.OR.E.005. Kur operatori i aerodromit ndryshon, operatorit të ri të aerodromit nuk do t’i kërkohej të demonstrojë përputhjen me kërkesat e përcaktuara në pikën ADR.OR.B.025“a”/1 dhe pikën ADR.OR.E.005, nëse këto kërkesa kanë të bëjnë me elemente që mbeten të pandryshuara.”.

10. pas pikës ADR.AR.C.040 shtohet pika ADR.AR.C.040A, si më poshtë:

“ADR.AR.C.040A Ndryshimet në sistemin e menaxhimit të sigurisë së informacionit:

a) Lidhur me ndryshimet e menaxhuara dhe të njoftuara Autoritetit të Aviacionit Civil në përputhje me procedurën e përcaktuar në pikën IS.D.OR.255”a” të aneksit (Pjesa–IS.D.OR) të rregullores së deleguar të BE-së 2022/1645, në lidhje me kërkesat për menaxhimin e rreziqeve të sigurisë së informacionit me një ndikim të mundshëm në sigurinë në operim për organizatat kur të jetë e zbatueshme me përafrimin e saj me legjislacionin e brendshëm, Autoriteti i Aviacionit Civil duhet të përfshijë shqyrtimin e ndryshimeve të tilla në mbikëqyrjen e tij të vazhdueshme në përputhje me parimet e përcaktuara në pikën ADR.AR.C.005. Nëse gjendet ndonjë mospërputhje, Autoriteti i Aviacionit Civil duhet të njoftojë organizatën për këtë, të kërkojë ndryshime të mëtejshme dhe të veprojë në përputhje me pikën ADR.AR.C.055;

b) Lidhur me ndryshimet e tjera që kërkojnë një aplikim për miratim në përputhje me pikën IS.D.OR.255“b” të aneksit (Pjesa–IS.D.OR) të rregullores së deleguar të BE-së 2022/1645, në lidhje me kërkesat për menaxhimin e rreziqeve të sigurisë së informacionit me një ndikim të mundshëm në sigurinë në operim për organizatat kur të jetë e zbatueshme me përafrimin e saj me legjislacionin e brendshëm.

1. Pas marrjes së aplikimit për ndryshim, Autoriteti i Aviacionit Civil duhet të kontrollojë përputhshmërinë e organizatës me kërkesat përkatëse përpara se të lëshojë miratimin;

2. Autoriteti i Aviacionit Civil përcakton kushtet sipas të cilave organizata mund të veprojë gjatë zbatimit të ndryshimit;

3. nëse është i bindur se organizata përputhet me kërkesat përkatëse, Autoriteti i Aviacionit Civil miraton ndryshimin.”.

11. Pas pikës ADR.AR.C.055 shtohet pika ADR.AR.C.060 si më poshtë:

“ADR.AR.C.060 Ndërrimi i operatorit të aerodromit

Me marrjen e një aplikimi për ndryshimin e operatorit të aerodromit, në përputhje me pikën ADR.OR.B.060, Autoriteti i Aviacionit Civil:

a) lëshon certifikatën(et) e re në përputhje me pikën ADR.AR.C.035;

b) revokon certifikatën(at) e mëparshme;

5. Në aneksin III bëhen ndryshimet, si më poshtë:

a) pas pikës ADR.OR.B.050 shtohet pika ADR.OR.B.060, si më poshtë:

“ADR.OR.B.060 Ndërrimi i operatorit të aerodromit

a) Operatori aktual i aerodromit do t'i njoftojë Autoritetit të Aviacionit Civil datën në të cilën do të ndodhë transferimi;

b) Operatori i ri të cilit do t'i transferohet menaxhimi i aerodromit do të aplikojë për një certifikatë pranë Autoritetit të Aviacionit Civil, përpara datës në të cilën do të kryhet transferimi, në përputhje me pikën ADR.OR.B.015;

c) Operatori i ri, të cilit do t'i transferohet menaxhimi i aerodromit, duhet të demonstrojë pajtueshmërinë, në përputhje me pikën ADR.OR.B.025. Operatorit të ri të aerodromit nuk do t'i kërkohet të demonstrojë përputhjen me kërkesat e përcaktuara në pikën ADR.OR.B.025“a”/1 dhe pikën ADR.OR.E.005, nëse këto kërkesa kanë të bëjnë me elemente që mbeten të pandryshuara;”;

b) Në pikën ADR.OR.C.020, pas shkronjës “c” shtohet shkronja “d”, si më poshtë:

“d) informon organizatat e shërbimeve të përpunimit në tokë në aerodrom për veprimin e ndërmarrë për të adresuar mospërputhjen kur mospërputhja ndikon drejtpërdrejt në rrezikun e sigurisë në operim brenda këtyre organizatave të shërbimit të përpunimit në tokë ose në përgjegjësitë e tyre.”;

c) Pika ADR.OR.C.030 zëvendësohet me sa vijon:

“ADR.OR.C.030 Raportimi i ngjarjeve

a) Si pjesë e sistemit të tij të menaxhimit, operatori i aerodromit do të krijojë dhe mirëmbajë një sistem raportimi të ngjarjeve, duke përfshirë raportimin e detyrueshëm dhe vullnetar. Operatori i aerodromit duhet të sigurojë që sistemi të jetë në përputhje me kërkesat e zbatueshme të urdhrin të ministrit nr. 89, datë 5.5.2022, “Për miratimin e rregullores për raportimin dhe ndjekjen e ngjarjeve në aviacionin civil në Republikën e Shqipërisë” dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1095, datë 24.12.2020, “Për miratimin e kërkesave thelbësore në fushën e aviacionit civil”, i ndryshuar, si dhe aktet nënligjore në zbatim të tij;

b) Operatori i aerodromit do t'i raportojë Autoritetit të Aviacionit Civil dhe çdo organizatë tjetër të kërkuar nga legjislacioni kombëtar çdo ngjarje ose gjendje, të lidhur me sigurinë në operim që rrezikon ose, nëse nuk korrigjohet ose adresohet, mund të rrezikojë një avion, pasagjerët e tij ose çdo person tjetër, dhe në veçanti çdo aksident ose incident serioz;

c) Përveç raporteve të paraqitura në përputhje me shkronjën “b”, operatori i aerodromit do t'i raportojë Autoritetit të Aviacionit Civil dhe organizatës përgjegjëse për projektimin e pajisjeve të aerodromit çdo mosfunksionim, defekt teknik, tejkalim të kufizimeve teknike, dukuri ose rrethanë tjetër të parregullt që ka ose mund të ketë rrezikuar një avion, pasagjerët e tij ose çdo person tjetër dhe nuk ka rezultuar në një aksident ose incident serioz;

d) Pa cenuar urdhrin e ministrit nr. 89, datë 5.5.2022, “Për miratimin e rregullores për raportimin dhe ndjekjen e ngjarjeve në aviacionin civil në Republikën e Shqipërisë”, raportet e përmendura në shkronjën “c” do të:

1. Bëhen sa më shpejt që të jetë e mundur, por në çdo rast brenda 72 orëve nga momenti kur operatori i aerodromit të ketë marrë dijeni për ngjarjen ose gjendjen me të cilën lidhet raporti, përveç rasteve kur rrethanat e jashtëzakonshme e pengojnë këtë;

2. Bëhen në formën dhe mënyrën e përcaktuar nga Autoriteti i Aviacionit Civil;

3. Përmbajnë të gjithë informacionin përkatës në lidhje me gjendjen e njohur për operatorin e aerodromit.

e) Pa cenuar urdhrin e ministrit nr. 89, datë 5.5.2022, “Për miratimin e rregullores për raportimin dhe ndjekjen e ngjarjeve në aviacionin civil në Republikën e Shqipërisë”, për raportet e kërkuara nga shkronja “c” operatori i aerodromit duhet të paraqesë një raport pasues që ofron detaje të veprimeve që operatori i aerodromit synon të ndërmarrë për të parandaluar ngjarje të ngjashme në të ardhmen. Raporti pasues do të dorëzohet sapo këto veprime të jenë identifikuar dhe ai duhet:

1. t'u dërgohet subjekteve përkatëse të raportuara fillimisht në përputhje me shkronjat “b” dhe “c”;

2. të bëhet në formën dhe mënyrën e përcaktuar nga Autoriteti i Aviacionit Civil.”;

ç) Në pikën ADR.OR.D.005, shtohet shkronja “f”, si më poshtë:

“f) Nëse operatori i aerodromit është pjesë e një subjekti juridik që mban një ose më shumë certifikata, miratime ose autorizime shtesë organizative, ose deklaron aktivitetet e tij në përputhje me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 1095, datë 24.12.2020, “Për miratimin e kërkesave thelbësore në fushën e aviacionit civil”, i ndryshuar, operatori i aerodromit mund ta integrojë sistemin e tij të menaxhimit në sistemin e menaxhimit të kërkuar sipas kësaj rregulloreje.”;

d) Në pikën ADR.OR.D.005“b”, pika 11 zëvendësohet me sa vijon:

“11. Një funksion për të monitoruar përputhshmërinë e organizatës me kërkesat përkatëse dhe përshtatshmërinë e procedurave; Monitorimi i përputhshmërisë duhet të përfshijë një sistem reagimi të gjetjeve për menaxherin përgjegjës për të siguruar zbatimin efektiv të veprimeve korrigjuese, sipas nevojës.”;

dh) Pas pikës ADR.OR.D.005 shtohet pika ADR.OR.D.005A, si më poshtë:

“ADR.OR.D.005A Sistemi i menaxhimit të sigurisë së informacionit

Operatori i aerodromit duhet të krijojë, zbatojë dhe mirëmbajë një sistem menaxhimi të sigurisë së informacionit në përputhje me rregulloren e deleguar të BE-së 2022/1645, në lidhje me kërkesat për menaxhimin e rreziqeve të sigurisë së informacionit me një ndikim të mundshëm në sigurinë në operim për organizatat kur të jetë e zbatueshme me përafrimin e saj me legjislacionin e brendshëm, me qëllim që të sigurojë menaxhimin e duhur të rreziqeve të sigurisë së informacionit që mund të kenë ndikim në sigurinë në operim.”;

e) Pika ADR.OR.D.007 zëvendësohet me sa vijon:

“ADR.OR.D.007 Menaxhimi i të dhënave aeronautike dhe informacionit aeronautik

a) Si pjesë e sistemit të tij të menaxhimit, operatori i aerodromit duhet të zbatojë dhe mirëmbajë një sistem menaxhimi të cilësisë që mbulon aktivitetet e mëposhtme:

1. aktivitetet e tij të të dhënave aeronautike;
2. aktivitetet e tij të ofrimit të informacionit aeronautik;

b) Si pjesë e sistemit të tij të menaxhimit, operatori i aerodromit duhet të krijojë një sistem menaxhimi sigurie për të garantuar sigurinë e të dhënave operative që ai merr, prodhon ose përdor, në mënyrë që akses në ato të dhëna operative të kufizohet vetëm për personelin e autorizuar;

c) Sistemi i menaxhimit të sigurisë duhet të përcaktojë elementet e mëposhtme:

1. Procedurat që lidhen me vlerësimin dhe zbutjen e rrezikut të sigurisë së të dhënave, monitorimin dhe përmirësimin e sigurisë, rishikimet e sigurisë dhe shpërndarjen e mësimave të marra;

2. Mjetet e projektuara për të zbuluar shkeljet e sigurisë dhe për të njoftuar personelin me paralajmërime të përshtatshme sigurie;

3. Mjetet për të kontrolluar efektet e shkeljeve të sigurisë dhe për të identifikuar veprimet e rimëkëmbjes dhe procedurat e zbutjes për të parandaluar përsëritjen;

d) Operatori i aerodromit duhet të garantojë autorizimin e sigurisë së personelit të tij, në lidhje me sigurinë e të dhënave aeronautike.

e) Aspektet që lidhen me sigurinë e informacionit duhet të menaxhohen në përputhje me pikën ADR.OR.D.005A.”;

ë) Pika ADR.OR.D.020 ndryshohet, si më poshtë:

i. shkronja “b” zëvendësohet me sa vijon:

“b) Operatori i aerodromit cakton zona të përshtatshme në aerodrom që do të përdoren për ruajtjen e mallrave të rrezikshme të transportuara përmes aerodromit. Kushtet e ruajtjes për mallrat e rrezikshme duhet të garantojnë të dyja sa në vijim:

1. Ndarja e mallrave të rrezikshme mund të sigurohet sipas standardeve ndërkombëtare dhe praktikave të rekomanduara;

2. Facilitetet ofrojnë kushte të përshtatshme për të parandaluar çdo dëmtim të artikujve të mallrave të rrezikshme.”;

ii. pas shkronjës “b” shtohet shkronja “c”, si më poshtë:

“c) Kur operatori i aerodromit cakton, gjithashtu, zona të përshtatshme në aerodrom që do të përdoren për ruajtjen e pajisjeve të ngarkim-shkarkimit, ai duhet të sigurojë që këto zona të jenë të përshtatshme për të parandaluar dëmtimin, përkeqësimin ose ruajtjen e tyre në tokë dhe për të siguruar mbrojtje nga kushte të pafavorshme të motit.”;

f) Pika ADR.OR.D.025 zëvendësohet me sa vijon:

“ADR.OR.D.025 Koordinimi me organizatat e tjera

Operatori i aerodromit do të:

a) garantojë se sistemi i tij i menaxhimit adreson koordinimin dhe ndërveprimin me procedurat e sigurisë në operim të organizatave të tjera që operojnë ose ofrojnë shërbime në aerodrom;

b) garantojë se këto organizata kanë në fuqi procedura mbi sigurinë në operim me qëllim përmbushjen e kërkesave të zbatueshme të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1095, datë 24.12.2020, “Për miratimin e kërkesave thelbësore në fushën e aviacionit civil”, i ndryshuar, dhe akteve nënligjore në zbatim të tij, si dhe kërkesave të përcaktuara në manualin e aerodromit të krijuar dhe mirëmbajtur në përputhje me pikën ADR.OR.E.005 të këtij aneksi.”;

g) Pika ADR.OR.D.027 zëvendësohet me sa vijon:

“ADR.OR.D.027 Programet e sigurisë në operim dhe komitetet e sigurisë në operim të aerodromit

a) Si pjesë e sistemit të tij të menaxhimit, operatori i aerodromit do të krijojë, zbatojë dhe udhëheqë programe sigurie në operim për të promovuar dhe rritur sigurinë në operim, duke përfshirë sigurinë në operim të pistës dhe shkëmbimin e informacionit të rëndësishëm për sigurinë në operim me të gjitha organizatat përkatëse që operojnë ose ofrojnë shërbime në aerodrom. Operatori i aerodromit duhet të rishikojë, të paktën çdo vit, efektivitetin e programeve të tij të sigurisë në operim;

b) Si pjesë e programeve të sigurisë në operim të përmendura në shkronjën “a”, operatori i aerodromit duhet:

1. të krijojë, udhëheqë dhe të jetë përgjegjës për funksionimin e ekipit lokal të sigurisë në operim të pistës dhe komiteve të tjera të sigurisë në operim të aerodromit;

2. kërkojë nga të gjitha organizatat përkatëse që operojnë ose ofrojnë shërbime në aerodrom që të marrin pjesë në ekipin lokal të sigurisë në operim të pistës dhe në komitetet e tjera të sigurisë në operim të aerodromit nëpërmjet përfaqësuesve të emëruar që kanë ekspertizën e duhur dhe të përshtatshme operationale, përkatësisht me subjektin e ekipit lokal të sigurisë në operim të pistës ose përkatësisht komitetit(eve) të sigurisë në operim të aerodromit;

c) Operatori i aerodromit duhet të sigurojë që:

1. Ekipi lokal i sigurisë në operim të pistës dhe komitetet e tjera të sigurisë në operim të aerodromit organizojnë rregullisht mbledhje, frekuenca e të cilave do të përcaktohet bazuar [të paktën] në:

i. dendësinë e trafikut të aerodromit;

ii. kompleksitetin e konfigurimit të aerodromit;

iii. llojin e operimeve;

iv. ngjarjet e sigurisë në operim në aerodrom dhe risqet e mundshme të identifikuara nga analiza e tyre;

2. Propozimet dhe veprimet e ekipit lokal të sigurisë në operim të pistës dhe komiteve të tjera të sigurisë në operim të aerodromit regjistrohen në një plan veprimi dhe ndiqen për të siguruar zbatimin e tyre në kohën e duhur;

d) Ekipi lokal i sigurisë në operim të pistës dhe komitetet e tjera të sigurisë në operim të aerodromit duhet të:

1. mbështesin identifikimin dhe rishikimin multidisiplinor të çështjeve lokale të sigurisë në operim, veçanërisht në lidhje me sigurinë në operim të pistës;

2. propozojnë masat e mundshme zbutëse dhe planet përkatëse të veprimit që do të zbatohen nga organizatat përkatëse për të rritur sigurinë në operim;

3. marrin në konsideratë nevojën për të zhvilluar fushata të rregullta lokale të ndërgjegjësimit për sigurinë në operim dhe programe të përbashkëta trajnimi për personelin e të gjitha organizatave përkatëse;

e) Operatori i aerodromit vendos dhe zbaton një procedurë ose procedura për të siguruar zbatimin e shkronjave “a” deri në “d”.”;

gj) Në pikën ADR.OR.D.030, shtohet “ab”, si më poshtë:

“ab) Operatori i aerodromit do të krijojë marrëveshje raportimi me të gjitha organizatat që operojnë ose ofrojnë shërbime në aerodrom, aktivitetet ose produktet e të cilave mund të kenë ndikim në sigurinë në operim të avionit.”;

h) Në pikën ADR.OR.E.005, shkronja “f” zëvendësohet me sa vijon:

“f) Pavarësisht shkronjës “e”, kur kërkohen ndryshime ose rishikime në interes të sigurisë në operim, ato mund të publikohen dhe të zbatohen menjëherë, me kusht që të jetë aplikuar për marrjen e çdo miratimi të kërkuar. Ndryshimet dhe rishikimet në lidhje me aktivitetet e shërbimit në tokë që i nënshtrohen rregullores së deleguar të Komisionit të BE-së 2025/20, që përcakton kërkesat për ofrimin e sigurt të shërbimeve të përpunimit në tokë dhe për organizatat që i ofrojnë ato, nuk kërkohet që t’i paraqiten autoritetit kompetent për miratim.”;

i) në pikën ADR.OR.F.045, shtohet shkronja “d”, si më poshtë:

“d) Pavarësisht shkronjave “a” deri në “c”, nëse ofruesi i AMS-së është pjesë e një subjekti juridik që deklaron përgjegjësinë e tij për ofrimin e shërbimeve në tokë, në përputhje me rregulloren e deleguar të BE-së 2025/20, që përcakton kërkesat për ofrimin e sigurt të shërbimeve të përpunimit në tokë dhe për organizatat që i ofrojnë ato, ofruesi i AMS-së mund ta integrojë sistemin e tij të menaxhimit me sistemin e menaxhimit të kërkuar sipas kësaj rregulloreje.”;

j) Pika e mëposhtme ADR.OR.F.045A shtohet pas pikës ADR.OR.F.045:

“ADR.OR.F.045A Sistemi i menaxhimit të sigurisë së informacionit

Organizata përgjegjëse për ofrimin e AMS-së duhet të krijojë, zbatojë dhe mirëmbajë një sistem menaxhimi të sigurisë së informacionit në përputhje me rregulloren e deleguar të BE-së 2022/1645, në lidhje me kërkesat për menaxhimin e rreziqeve të sigurisë së informacionit me një ndikim të mundshëm në sigurinë në operim për organizatat kur të jetë e zbatueshme me përafrimin e saj me legjislacionin e brendshëm, me qëllim sigurimin e menaxhimit të duhur të rreziqeve të sigurisë së informacionit që mund të kenë ndikim në sigurinë në operim të aviacionit.”;

k) Në pikën ADR.OR.F.055 shtohet shkronja “e”. si më poshtë:

“e) Organizata përgjegjëse për ofrimin e AMS-së duhet të sigurojë që çdo ngjarje t’i raportohet personit që kryen një funksion të lidhur me menaxhimin e sigurisë në operim të operatorit të aerodromit, në përputhje me nenin 4/6, shkronja “e”, të urdhrit të ministrit nr. 89, datë 5.5.2022, “Për miratimin e rregullores për raportimin dhe ndjekjen e ngjarjeve në aviacionin civil në Republikën e Shqipërisë”.”.

6. Në aneksin IV bëhen ndryshimet, si më poshtë:

a) shtohet pika e mëposhtme ADR.OPS.B.011:

“ADR.OPS.B.011 Heqja e avionëve jashtë funksionit

a) Operatori i aerodromit do të krijojë një plan për heqjen e një avioni jashtë funksionit në zonën e lëvizjes dhe do të caktojë një koordinator aerodromi për të zbatuar planin;

b) Plani i heqjes së avionit jashtë funksionit duhet të përfshijë sa vijon:

1. detajet e kontaktit të koordinatorit të aerodromit për operimet mbi heqjen e një avioni jashtë funksioni në ose ngjitur me zonën e lëvizjes;

2) përgjegjësitë, veprimet dhe linjat e komunikimit për secilën organizatë të përfshirë;
 3) një listë të pajisjeve dhe një listë të personelit në, ose në afërsi të aerodromit, të cilat janë të disponueshme për këtë qëllim;

4) çdo marrëveshje për marrjen e shpejtë të completeve të pajisjeve të rikuperimit të avionëve të disponueshëm nga aerodrome të tjerë, sipas rastit.”;

b) Në pikën ADR.OPS.B.031 shtohen shkronjat “c” dhe “d”, si më poshtë:

“c) Nëse sinjalet përdoren në përputhje me shkronjën “b”/4, ato do të kenë kuptimin e mëposhtëm:

Sinjali i dritës nga kontrolli i aerodromit	Kuptimi
Pulsime/Fleshime jeshile	Leje për të kaluar zonën e uljes ose për të lëvizur në rrugë lidhëse
E kuqe e qëndrueshme	Ndaloni
Pulsime/Fleshime të kuqe	Lëvizni nga zona e uljes ose rruga lidhëse dhe kini kujdes avionët
Pulsime/Fleshime të bardha	Dilni nga zona e manovrimit, në përputhje me udhëzimet lokale

d) Në kushte emergjence ose nëse sinjalet në shkronjën “c” nuk shikohen, sinjali i dhënë më poshtë do të përdoret për pistat ose rrugët lidhëse të pajisura me një sistem ndriçimi dhe do të ketë kuptimin e mëposhtëm:

Sinjali i dritës nga kontrolli i aerodromit	Kuptimi
Dritat pulsuese të pistës ose rrugës lidhëse	Dilni nga pista dhe vëzhgoni kullën për sinjal drite

c) Pika ADR.OPS.B.033:

i) shkronja “a”/3) zëvendësohet me sa vijon:

“3) kontrolluar lëvizjen e personave në vendqëndrimin e avionëve”;

ii. shtohet shkronja e mëposhtme “a1”:

“a1) Operatori i aerodromit duhet të vendosë procedura për të siguruar që pasagjerët që hipin ose zbresin nga një avion, ose që kanë nevojë të ecin në, nga ose përtej vendqëndrimit të avionëve:

1. të shoqërohen nga personel i trajnuar dhe kompetent;
2. nuk ndërhyjnë në aktivitetet e shërbimit të avionëve të palëvizshëm dhe aktivitetet e shërbimeve të përpunimit në tokë;
3. janë të mbrojtur nga avionët që janë në operim, duke përfshirë efektet e motorëve të tyre, si dhe aktivitete të automjeteve ose aktivitete të tjera.”;

ç) Pika ADR.OPS.B.070 zëvendësohet me sa vijon:

adr.OPS.B.070 Siguria në operim e punimeve në aerodrom

a) Operatori i aerodromit do të vendosë dhe zbatojë një proces për menaxhimin e sigurisë në operim të aerodromit gjatë punimeve në zonën e lëvizjes.

b) Procesi do të përcaktojë dhe dokumentojë përgjegjësitë, në lidhje me:

1. autorizimin për kryerjen e punimeve;
2. zbatimin e çdo ndryshimi të propozuar në hapësirat ku operohet;
3. datën dhe orën kur operimet në hapësirat do të kufizohen ose ndërpriten;
4. metodat me të cilat do të shpallen ndryshime të tilla;
5. mbikëqyrjen dhe kontrollin e punimeve në vazhdim;
6. pajtueshmërinë me të gjitha rregullat përkatëse të sigurisë në operim të zonës së lëvizjes;

c) Procesi për menaxhimin e sigurisë në operim të aerodromit gjatë punimeve duhet të përmbajë elementet e mëposhtme:

1. një procedurë të planifikimit të punimeve;
2. një procedurë për vlerësimin e impaktit të sigurisë në operim të ndryshimeve të planifikuara në operimet ose sistemet e aerodromit;

3. procedurën e autorizimit të punimeve;
 4. një procedurë për shpalljen e informacionit në lidhje me punimet;
 5. një procedurë për vendosjen e kantierit dhe kthimin në operim;
 6. një procedurë për monitorimin, mbikëqyrjen dhe kontrollin e punimeve;
- d) Aty ku kërkohen operime me gjatësi të reduktuar të pistës për shkak të punimeve, operatori i aerodromit duhet të zhvillojë dhe zbatojë një procedurë për operime të tilla.”;

d) Pas pikës ADR.OPS.B.070 shtohet pika ADR.OPS.B.071 si më poshtë:

“ADR.OPS.B.071 Pistat dhe rrugët lidhëse të mbyllura, ose pjesë të tyre

- a) Operatori i aerodromit duhet të sigurojë që vijëzimet e mbylljes të shfaqen mbi:
1. një pistë ose një rrugë lidhëse, ose një pjesë e saj, e cila është e mbyllur përgjithmonë për t’u përdorur nga të gjithë avionët;
 2. një pistë ose rrugë lidhëse e mbyllur përkohësisht, ose një pjesë e saj, përveç rasteve kur këto vijëzime mund të anashkalohen kur mbyllja është me kohëzgjatje të shkurtër dhe kur ofrohet paralajmërimi i duhur nga shërbimet e trafikut ajror;
- b) Me përjashtim të shkronjës “a”, një vijëzim mbylljeje nuk duhet të shfaqet në një rrugë lidhëse të mbyllur përgjithmonë ose pjesë të saj, nëse hyrja në rrugën lidhëse të mbyllur, ose pjesë të saj është e shënuar dhe e ndriçuar me drita dhe shënues të mospërdorimit;
- c) Operatori i aerodromit duhet të sigurojë që kur një pistë ose një rrugë lidhëse, ose një pjesë e saj mbyllet përgjithmonë të gjitha vijëzimet e pistës dhe rrugës lidhëse hiqen fizikisht;
- d) Operatori i aerodromit duhet të sigurojë që ndriçimi në një pistë ose rrugë lidhëse të mbyllur, ose në një pjesë të saj, të mos jetë i ndezur, përveçse kur kërkohet për qëllime mirëmbajtjeje;
- e) Operatori i aerodromit duhet të sigurojë që përveç vijëzimeve mbyllëse, kur një pistë, një rrugë lidhëse ose një pjesë e saj mbyllet dhe ndërpritet nga një pistë ose rrugë lidhëse, e cila përdoret gjatë natës, të vendosen dritat e papërdorshmërisë përgjatë hyrjes në zonën e mbyllur.”;

dh) Pika ADR.OPS.B.090 zëvendësohet me sa vijon:

“ADR.OPS.B.090 Përdorimi i aerodromit nga avionët që tejkalojnë karakteristikat e certifikuara të projektimit të aerodromit

- a) Për të lejuar përdorimin e aerodromit ose pjesëve të tij nga avionët që tejkalojnë kodin e germës ose hapjen e jashtme të rrotave të ingranazheve kryesore, ose të dyja karakteristikat e certifikuara të projektimit të aerodromit, operatori i aerodromit duhet të aplikojë për miratimin paraprak tek Autoriteti i Aviacionit Civil, një miratim i tillë nuk kërkohet për situatat emergjente të avionit;
- b) Në kërkesën për miratimin paraprak të Autoritetit të Aviacionit Civil për avionët e përmendur në shkronjën “a”, operatori i aerodromit do të përfshijë një vlerësim të ndikimit të karakteristikave të mëposhtme të avionit në infrastrukturën e aerodromit, objektet, pajisjet dhe funksionimin e tij dhe anasjelltas:
1. gjerësia e krahëve të avionit;
 2. gjerësia ndërmjet skajeve të jashtme të rrotave kryesore të uljes;
 3. bazamenti i rrotave;
 4. gjatësia e avionit;
 5. gjerësia e strukturës së avionit;
 6. lartësia e strukturës së avionit;
 7. gjeometria e hundës së avionit;
 8. lartësia e bishtit;
 9. lartësia e majës së krahut nga toka;
 10. pamja e kabinës së pilotit;
 11. distanca nga pozicioni i syrit të pilotit deri tek pajisja e uljes së parme;
 12. konfigurimi i pajisjes kryesore të uljes;

13. sistemi i drejtimit të rrotave;
14. pesha maksimale e avionit;
15. gjeometria e pajisjeve të uljes, presioni i gomave dhe vlerat e klasifikimit të avionit;
16. karakteristikat e motorit të avionit;
17. kapaciteti maksimal i mbajtjes pasagjerëve dhe karburantit;
18. performanca e fluturimit.”;

e) Pas pikës ADR.OPS.B.090 shtohen pikat ADR.OPS.B.095 dhe ADR.OPS.B.100 si më poshtë:

“ADR.OPS.B.095 Pikat e nxehta

a) Kurdoherë që është e nevojshme, operatori i aerodromit do të caktojë një vendndodhje ose disa vendndodhje në zonën e lëvizjes së aerodromit si “pikat e nxehta”, si pjesë e programit të sigurisë në operim që ka ngritur në përputhje me pikën ADR.OR.D.027;

b) Pasi të jetë identifikuar një pikë e nxehtë, operatori i aerodromit duhet të zbatojë masat për të hequr rrezikun dhe nëse kjo nuk është e mundur menjëherë, t’i japë të dhënat përkatëse aeronautike njësisë përgjegjëse të shërbimeve të informacionit aeronautik (AIS) për publikim në publikimin e informacionit aeronautik (AIP).

ADR.OPS.B.100 Pezullimi i operimeve në pistë dhe mbyllja e pistës

a) Operatori i aerodromit vendos dhe zbaton, në bashkëpunim me shërbimet e trafikut ajror, procedurat për pezullimin e përkohshëm të operimeve në pistë ose mbylljen e planifikuar të pistës.

b) Procedurat duhet të përmbajnë sa vijon:

1. rolet dhe përgjegjësitë e operatorit të aerodromit, shërbimeve të trafikut ajror dhe organizatave të tjera të përfshira në operimet e aerodromit, sipas situatës;
2. aksesin e personelit në pistën e mbyllur;
3. masat e sigurisë në operim, në përputhje me pikat ADR.OPS.B.070 dhe ADR.OPS.B.071;
4. publikimin e një NOTAM-i, në përputhje me pikën ADR.OPS.A.057, me përjashtim të rasteve kur pezullimi i operimeve në pistë pritet të jetë me kohëzgjatje të shkurtër;
5. veprimet përpara rifillimit të operimeve në pistës.”;

ë) Pas pikës ADR.OPS.C.010 shtohet pika ADR.OPS.C.011, si më poshtë:

“ADR.OPS.C.011 Operimet me ngarkesë të tepërt

Kurdoherë që aerodromi pritet të përdoret rregullisht nga avionë që mund të dëmtojnë dyshemetë, operatori i aerodromit vendos kritere për operimet me ngarkesë të tepërt.”.

f) Në pikën ADR.OPS.D.001, shkronja “a”/4 zëvendësohet me sa vijon:

“4) të mbulojnë sa vijon:

- i. caktimin e vendqëndrimeve të avionëve;
- ii. ofrimin e shërbimeve të drejtimit të avionëve;
- iii. parkimin dhe nisjen e avionëve nga vendqëndrimi;
- iv. masat paraprake të mbrojtjes nga efekti i goditjes gjatë vënies në punë të motorëve dhe testimit të motorëve;

v. udhëzimet/autorizimet e nisjes dhe udhëzimet për lëvizjen në rrugët lidhëse.”;

g) Pika ADR.OPS.D.060 zëvendësohet me sa vijon:

“ADR.OPS.D.060 Siguria në vendqëndrim gjatë furnizimit me karburant të avionit

a) Operatori i aerodromit duhet të hartojë një procedurë për të garantuar sigurinë e operimeve në vendqëndrim gjatë furnizimit me karburant të avionit;

b) Procedura duhet të kërkojë sa vijon:

1. ndalimin e flakëve të hapura dhe përdorimin e mjeteve elektrike ose të ngjashme nga personeli në afërsi të pikës së furnizimit me karburant, të cilat mund të prodhojnë shkëndija ose harqe elektrike brenda zonës së furnizimit me karburant;

2. ndalimin e ndezjes së njësive të karikimit me energji tokësore gjatë furnizimit me karburant;

3. për autobotet për transportin e karburantit: ekzistencën e një rruge të papenguar nga avioni për të lejuar largimin e shpejtë të autoboteve për transportin e karburantit dhe personave në rast emergjence;

4. lidhjen e saktë të burimeve të furnizimit të avionëve dhe karburantit si dhe zbatimin e saktë të procedurave të tokëzimit;

5. njoftimin e menjëhershëm të ofruesit të shërbimit të furnizimit me karburant në avion në rast të derdhjes së karburantit dhe udhëzimet e hollësishme se si të trajtohen derdhjet e karburantit;

6. pozicionimin e pajisjeve mbështetëse të përpunimit në tokë në mënyrë të tillë që daljet e emergjencave të jenë të lira nga çdo pengesë për të lejuar evakuimin e shpejtë të pasagjerëve, nëse pasagjerët hipin ose zbresin ose qëndrojnë në avion gjatë furnizimit me karburant;

7. disponueshmërinë e menjëhershme të fikësve të zjarrit të llojit të përshtatshëm për të paktën ndërhyrjen fillestare në rast zjarri nga karburanti;

8. sigurimin e daljes pa pengesa për automjetin që furnizon me karburant dhe aksesin pa pengesa në hidrantin e karburantit dhe në ndalesën e emergjencës;

9. ndërprerjen e operimeve të furnizimit me karburant nëse ka stuhi elektrike në aerodrom ose në afërsi të tij.”

II. DISPOZITAT KALIMTARE

1. Pikat 5/“ç”, 5/“d”, 5/“f”, 4/2, 4/4, 4/5, 4/6, 4/8, 4/10, të tekstit do të zbatohen nga data 22 shkurt 2026.

2. Pikat 5/“b”, 5/“ë”, 5/“h”, 5/“i”, 6/“c”, 6/“f”, 6/“g” të tekstit do të zbatohen nga data 27 mars 2028.